



WE ARE EXPERTS ON
CONCRETE



Ndërtimi i objekteve të banimit dhe afariste me elementet të parafabrikuara prej betoni

Zhvillimi urbanistik, zgjerimi i qyteteve dhe kërkesave për ndërtim të shpejtë, në dekadat e fundit ka bërë që gama e gjerë e materialeve ndërtimore të cilat mundësojnë ndërtimin e objekteve të banimit dhe atyre afariste të jenë nga materiale më të ndryshme. Më të sofistikuar janë prodhimet e elementeve prej betoni të parafabrikuar, prej të cilit mund të ndërtohen elementet e ndryshme strukturore.



Andaj, për të iu përgjigjur kërkesës për ndërtim të shpejt, të sigurt, si dhe me kosto më të ulët, **ALSTONE GROUP** me një eksperiencë prej 20 vitesh, lider në fushën e prodhimit të betonit, projektimit dhe ndërtimit vjen për herë të parë në Kosovë me prodhimin e elementeve të parafabrikuara, në theks të veçantë elementet e parafabrikuara të destinuara për ndërtim të objekteve të banimit dhe atyre afariste, si mure të dyfishta, pllaka, shkallët, elementet strukturor, si dhe elementet të ndryshme dekorative të hapësirave publike.

Prodhimi i mureve të parafabrikuar

Muri i dyfishtë i parafabrikuar përbëhet prej dy mureve prej betoni me trashësi 5-6 cm, të armuar me armaturë sipas llogarisë, të dy pjesët janë të lidhura mes veti duke përdorur shufrat e hekuri dhe trarëzat në formë kapriate. Muri i dyfishtë i parafabrikuar prej betoni kombinon saktësinë dimensionale dhe kontrollin e cilësisë së mureve, duke mundësuar kualitet të lartë.

Departamenti ynë i dizajnit/projektimit përdor softuerin më të sofistikuar për të prodhuar modele 3D të strukturave dhe siguron skicat e të dhënave ku dërgohen direkt në fabrikën e prodhimit ku bëhet prodhimi i tyre nën kontrolla strikte të të gjitha aspekteve teknike si përforcimi, betonimi e deri tek transportimi i tyre në vendpunishte.

Modeli 3D i strukturës



Detali i armimit të murit të dyfishtë

Gjatë prodhimit të këtyre mureve parashihen hapjet e dyerve dhe dritareve, kutitë e shpërndarjes për instalime elektrike dhe instalimet të tjera të paraparë sipas projektit.

Pasi që përfundon procesi i prodhimit të mureve në fabrikë, bëhet transportimi i tyre, ku secili element ka nomenklaturën e tij të pozicionimit të tij në teren në bazë të projektit.



Shtrirja e instalimeve dhe pregatitja e murit për betonim



Pregaditja e mureve për transport

Fazat e ndërtimit

Pasi që është përcaktuar lokacioni ku do të ndërtohet objekti bëhet locimi i objektit, pregaditja e terrenit për punimin e bazës së fundamentit, fundament ky i cili punohet i njëjtë sikurse për të gjitha ndërtimet tjera klasike.

Pasi është punuar baza e fundamenti të objektit bëhet montimi i mureve të parafabrikuara të cilët lidhen me bazën e fundamentit me anë të ankerave, të cilat janë të vendosura në distancë të paraparë sipas llogaris statike.



Montimi i mureve në bazën e themeleve

Mundësojnë lidhje të lehtë dhe shumë stabile mes mureve rrethuese dhe atyre ndarëse, në këto mure është e paraparë edhe hapësira e pozicionimit të shtyllave, armimi i të cilave punohen në vend punishte, sipas llogaris statike.


Gjatë montimit të tyre bëhet paraprakisht edhe vendosja e shiritave për papërshkrueshmëri të ujit.

Aplikimi i shiritave për pa përshkrueshmëri të ujit





Lidhja e mureve rrethuese
dhe atyre ndarëse.



Montimi i mureve ndarëse



Detali i lidhjes së mureve në kënde



Montimi i mureve përgjatë perimetrit të bodrumit.

Pas montimit të mureve në të gjithë etazhën e bodrumit bëhet porosia për furnizim me beton nga një prodhues lokal.



Furnizimi me beton për betonim të elementeve.



Pasi që është bërë furnizimi me beton sipas klasës së kërkuar bëhet betonimi i hapësirës mes mureve dhe elementeve të tjerë konstruktiv, ku paraprakisht përpara betonimit duhet të pastrohen nga të gjitha mbeturinat, jo vetëm për të siguruar rezistencën e objektit por edhe një tregues i rëndësishëm I nivelit tekniko-profesional të punës në kantier. Hedhja e betonit bëhet direkt nga pompa, duke mbushur vertikalisht të gjithë hapësirën mes mureve dhe elementeve të tjerë, betoni i hedhur në vepër vibrohet me vibrator të lehtë elektrik në intervale të caktuara kohore.



Mbushja e hapësirës së murevebme beton në vendpunishte


Pasi që janë montuar të gjitha muret e bodrumit dhe betonimit së hapësirës mes mureve me beton, bëhet përgaditja për montimin e pllakave gjysmë të parafabrikuara, ku paraprakisht bëhet vendosja e pahive metalike dhe trarëzave të cilat sigurojnë rezistencë si dhe lidhje më të mirë në mes të pllakës së parafabrikuar dhe betonit i cili do të vendoset në vepër.



Pllakat gjysmë të parafabrikuara janë të armuara me armaturë, sipas llogaris si dhe me trarëza në formë kapriate, pllakat gjysmë të parafabrikuara prodhohen në fabrikë,duke i'u përshtatur kërkesave të projektit, prodhohen në forma të ndryshme gjeometrike, ndërsa lartësia përfundimtare e pllakës arrihet në vendpunishte pasi që betonohet pjesa e sipërme e saj.

Vendosja e pahive metalike dhe trarëzave.






Në këto pllaka janë të vendosura kutit e shpërndarjes së instalimeve elektrike dhe instalimet të tjera.

Konstruksioni i pllakës gjysmë të parafabrikuar

Instalimet të ndryshme në pllakën e parafabrikuar




Pllaka e gatshme për montim në vend punishte.


Pllakat vendosen në bazë të planit të vendosje së tyre, në hapësirën ku është paraparë të mbulohet.

Vendosja e Pllakave gjysmë të parafabrikuara


Mbështetja e pllakës në muret bëhet sikurse në foton në vijim




Detali i lidhjes së murit me pllakën e meskatit




Detali i lidhjes së mureve rrethuese me pllakën e meskatit



Detali i murit ndarës (single) me pllakën e meskatit.




Modeli 3D i betonimit të pjesës së sipërme të pllakës



Aplikimi i shtresave të dyshemes në pllakën e parafabrikuar.

Në këto pllaka mund të aplikohen të gjitha shtresat e paraparë për mveshjen e dyshemesë.



Montimi i shkallëve të parafabrikuara.

Komunikimi i hapësirave vertikale bëhet përmes shkallëve të parafabrikuara të cilat prodhohen në fabrikë sipas kërkesës dhe dizajnit të investitorit dhe më pas montohen në vend punishte.

Këto mure mund të aplikohen edhe në etazhat tjera të objektit, ku montimi, vendosja dhe lidhja e tyre bëhet e njëjtë sikurse në etazhën e bodrumit duke i'u përshtatur hapësirës ku ato janë të parapara nëpër etazha.



Aplikimi i mureve të parafabrikuara në etazha tjerë të objektit

Në foton në vijim është prezantuar objekt i banimit ku janë aplikuar elementet të parafabrikuara prej betoni.



Aplikimi i elementeve të parafabrikuara në objektet të banimit

Trajtimi i këndeve të mureve në mënyrë të veçantë dhe aplikimi i materialeve hidroizoluese është prezantuar në foto si më poshtë:




Punimi i hidroizolimit

Një nga përparësit e ndërtimit me elementet të parafabrikuara është edhe ndërtimi në temperatura të ulta. Mveshja e mureve me materiale termoizoluese bëhet lehtë dhe shpejtë.




Termoizolimi i objektit

Muri ndarës me termoizolim për hapësirat e brendshme



Izolim i bërë nga materiali i izolues siguron ruajtjen e nxehtësisë si në mure të jashtme ashtu edhe në ato të brendshme dhe në këtë mënyrë parandalon ftohjen ose mbinxehjen e dhomave.



Muri ndarës në hapësirat e brendshme

Me këto elemente mund të ndërtohen jo vetëm objektet të banimit individual po edhe objektet kolektive, afariste etj.



Aplikimi i elementeve të parafabrikuara të objektet shumë katëshe

Aplikimi i elementeve të parafabrikuara në objektet kolektive dhe ato afariste

Shrytëzimi i shkallëve të parafabrikuara në objektet shumë katëshe.

Ekipi ynë i specializuar në këtë lëmi mbikqyrë punimet deri në finalizim të objektit.





Mbikqyrja dhe finalizmi i objektit me elemente të parafabrikuara.

Sot, **Alstone Group** është partner me renome për ndërtim, të pa kompromis për cilësinë më të mirë, duke përmbushur afatet kohore, të gjitha këto të dëshmuara nga referencat e shumta të cilat qëndrojnë pas nesh. I gjithë procesi i prodhimit është certifikuar sipas standardit **ISO 9002**

WE ARE EXPERT IN THE
SERVICES

ALSTONE

CONTACT:

Adres: KOSOVA | Bujar Thaci Nr 11 Rahovec

Phone: +377 44 301 239

E-mail: alstone.ks@gmail.com
Web: alstone-ks.com



Cert. Nr: QEC 53183234/18/Q

